



Komuna e Klinës

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

10 Nr. 644-36617/23

Klinë, dt. 23.10.2023

Duke u mbështetur në Vendimin e Asamblesë Komunale për ndarje të Çmimit Vjetor të Artit Figurativ "ART KLINA", të dt.27.03.2015, Nr.06-2588/2015 si dhe në Rregulloren për mbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblime tjera, Nr.01-06-4414/2015 e datës 20.07.2015, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

PËR ÇMIMIN "ART KLINA" - 2023

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë krijuesit e artit figurativ profesional me nga një punim të realizuar në teknikat: **vizatim, grafikë, pikturë dhe skulpturë.**

- Afati i dorëzimit të punimeve është nga dita e shpalljes së konkursit, pra nga data 23.10.2023 deri më 17.11.2023 (E premte, ora 16:00).

- Bashkë me punime, autorët duhet të dorëzojnë titullin e veprës, teknika, dimensionet dhe vitin e realizimit të veprës.

- Punimet konkurruese duhet të jenë të përgatitura teknikisht dhe të kornizuaru.

- Punimet e pranuar nga juria do të ekspozohen në Galerinë e Qendrës së Kulturës "Jehona e Dukagjinit" për nder të festës së 28 Nëntorit, hapja solemne e ekspozitës do të bëhet më datën 27.11.2023, ora 13:30.

- Juria profesionale me këtë rast, në hapjen solemne të ekspozitës vlerëson dhe jep **çmimin "ART KLINA" – 2023** sipas përcaktimit në vijim;

1. Çmimi kryesor "Art Klina" - 300 €

2. Vendi dytë - 100 €

3. Vendi tretë - 100 €

- Punimet fizike duhet të dorëzohen në Qendrën e Kulturës "Jehona e Dukagjinit" - Klinë, të zyrarët për kulturë:

Taulant Berisha nr. 049 840 173, e-mail: taulant.berisha@rks-gov.net dhe

Alban Gashi nr. 044 317 091, e-mail: alban.gashi@rks-gov.net

Fatjona Gashi

Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport

